



NEWSLETTER

2024



SHPIK 2024

2024 ka qenë një vit i jashtëzakonshëm për SHPIK, duke u angazhuar me mijëra të rinj dhe profesionistë në Kosovë përmes aktiviteteve dhe trajnimeve të shumta.



www.shpik.org

Në këtë buletin, do të gjeni një përmbledhje të arritjeve tona, të cilat pasqyrojnë përkushtimin tonë për të ndërtuar një të ardhme të ndritur digjitale për Kosovën. Ju falënderojmë për mbështetjen dhe presim me padurim sfidat dhe mundësitë që do të sjellë viti 2025.

AKTIVITETET KRYESORE TË VITIT



HOUR OF CODE




Një nga iniciativat më të mëdha të vitit 2024, Hour of Code nxiti kuriozitetin për teknologjinë dhe shkathtësitë për kodim te mijëra nxënës në Kosovë. Gjatë Javës Ndërkombëtare të Kodimit, nxënësit zhvilluan lojëra dhe aplikacione bazike, duke mësuar parimet e të menduarit logjik dhe zgjidhjes së problemeve. Aktiviteti u mbështet nga mësimdhënësit dhe partnerët e SHPIK-ut, të cilët ndihmuan në përhapjen e kodimit në të gjitha nivelet shkollore.

85,000 orë kodimi

350 shkolla

24 komuna

HOUR
OF
CODE





BEBRAS COMPUTING CHALLENGE



Sfida Bebras Computing Challenge 2024, e organizuar nga SHPIK, përfshiu me sukses mijëra nxënës nga shkollat e Kosovës, duke i sfiduar ata me detyra që zhvillojnë mendimin logjik dhe zgjidhjen e problemeve.

Kjo sfidë u organizua për herë të dytë në nivel vendi dhe përfshirja në finalen kombëtare dëshmoi përkushtimin e nxënësve dhe mësuesve. Kosova, për të dytin vit radhazi, u vendos në hartën ndërkombëtare të edukimit teknologjik.

1764

nxënës
pjesëmarrës

58


shkolla fillore dhe
të mesme

19

komuna nga e
gjithë Kosova

16 FINALISTË NGA SFIDA LOKALE

Nga 1764 pjesëmarrës në Sfidën Bebras lokale, vetëm 16 finalistë kaluan për të vazhduar garën në finalen që u mbajt më 30 nëntor 2024 në Prishtinë. Këta finalistë shfaqën shkathtësi të shkëlqyera në zgjidhjen e problemeve, duke konkurruar në një garë sfiduese dhe emocionuese.



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME DEEP TECH TALENT INITIATIVE



SHPIK në bashkëpunimi me Institutin Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit (EIT), synon të rrisë shkathtësitë në zhvillimin e programeve arsimore dhe certifikimeve moderne që plotësojnë standardet ndërkombëtare.

Marrëveshjet me Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA)

SHPIK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 12 Drejtori Komunale të Arsimit për implementimin e iniciativave si Hour of Code dhe Bebras. Përveç kësaj, janë organizuar trajnime të dedikuara për mësimdhënësit mbi përdorimin e platformës Code.org, duke mundësuar integrimin e kodimit në planprogramet shkollore dhe zhvillimin e aftësive teknologjike të nxënësit.




Marrëveshje partneriteti me SHFMU "Universum"

Ky partneritet synon të fuqizojë edukimin digjital duke ofruar trajnime për mësimdhënësit në platformën [Code.org](https://code.org), organizimin e aktiviteteve të kodimit për nxënësit dhe pjesëmarrjen në sfida ndërkombëtare si Bebras.



Marrëveshje partneriteti me DKA Suharekë / IAAP Skender Luarasi

Ky partneritet është i orientuar drejt arritjes së disa objektivave strategjike, të cilat janë jetike për përgatitjen e brezit të ri me aftësitë e duhura për t'u përballur me sfidat e tregut të punës në epokën digjitale




TRAJNIMET PËR IAAP-TË

SHPIK, me mbështetjen e LuxDev, përmbylli me sukses trajnimet për zbatimin e moduleve profesionale të pesë profileve të TIK-ut në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP).

Këto trajnime synojnë të avancojnë shkathtësitë dhe të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies në fushën e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (TIK).

- 01.** ZHVILLUES I APLIKACIONEVE
- 02.** TEKNIK I SISTEMEVE TË TIK-ut.
- 03.** TEKNIK I INFORMATIKËS SË BIZNESIT
- 04.** TEKNIK I DIZAJNIT GRAFIK.
- 05.** TEKNIK I MEDIAVE INTERAKTIVE.

19
SHKOLLA
PROFESIONALE





AKTIVITET TJERA PËR ANËTARËT

TRAJNIMI – MASTERI AI FOR VIDEO PRODUCTION

Trajnimi u fokusuan në përdorimin e teknologjive më të fundit si ChatGPT, MidJourney, Runway, dhe ElevenLabs. Pjesëmarrësit patën mundësinë të zhvillojnë projekte reale duke përdorur këto mjete të avancuara, duke nxitur kreativitetin dhe inovacionin në prodhimin e përmbajtjeve digjitale.



TRAJNIMET TJERA



NEXTGEN IMPACT MAKERS



Programi i Internshipit të NextGen ImpactMakers është realizuar me sukses, duke ofruar një mundësi të jashtëzakonshme për pjesëmarrësit e përgjedhur që të punojnë në projekte ambicioze dhe të fuqizojnë shkathtësitë e tyre. Gjatë një periudhe prej 6 muajsh, pjesëmarrësit kanë zhvilluar një projekt voluminoz nga fillimi deri në fund, duke përfshirë teknologji si backend, SQL, DB modelim, frontend, Java, .NET, REACT, UI/UX dhe SCRUM, nën mbikëqyrjen dhe me përkrahjen e profesionistëve të fushave përkatëse.



NextGen
ImpactMakers
**INTERNSHIP
PROGRAM**